

SHPENZIMET PUBLIKE 2020



Shpenzimet e Projektbuxhetit 2020 do të jenë rreth 532 miliardë lekë ose 29.7 % e PBB, me një rritje prej 5.1% krahasuar me të pritshtin e vitit 2019. Gjatë prezantimit në komisionin e Ekonomisë, Ministria informoi se shpenzimet e personelit janë të programuar në masën 83.5 miliardë lekë për vitin 2020, ku vendin kryesor e zënë efektet shtesë në zërin "Shpenzime personeli" që i atribuohen Reformës në Drejtësi, që kapin vlerën e 3.5 miliardë lekë. Sa i përket investimeve publike, ato janë planifikuar në nivelin e 4.7% të PBB ose rreth 84 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 4% kundrejt të pritshtit të këtij viti. Ministria nënvizoi faktin se në vitin 2020 do të ketë përparësi financimi i projekteve në vazhdim, duke synuar mbylljen e tyre brenda vitit 2021.

MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK



Niveli i borxhit të qeverisjes qendrore në raport me PBB ka hyrë në trajektore rënëse që prej vitit 2016 dhe vlerësimet për fundin e vitit 2019 tregojnë një rënie me rreth 2.5 pikë përqindje të borxhit të qeverisjes qendrore në raport me PBB. Në paralel me trajektoren rënëse të borxhit, edhe deficitit buxhetor ka rënë nën nivelet e 2%, e konkretisht: në vitin 2018 në 1.6 % dhe në vitin 2019 në 1.9 % ndaj PBB-së. Për vitin 2020, parashikimi vijon të jetë në nivelet e 1.6%. Gjatë diskutimit të borxhit publik dhe deficitit buxhetor në komisionin e Ekonomisë, Ministria Denaj theksoi se gjatë viteve të fundit kosto mesatare e borxhit është ulur ndjeshëm, pavarësisht rritjes së stokut të borxhit afatgjatë në portofol.

MONITORIMI I KONTRATAVE KONCESIONARE PPP



Në projektbuxhetin e vitit 2020 respektohen detyrimet ligjore dhe rregullat fiskale sa i përket koncesioneve dhe kontratave të partneritetit publik privat, me qëllim minimizimin apo eliminimin e risqeve që implikojnë buxhetin. Gjatë diskutimit të kesaj çështjeje në komisionin e Ekonomisë, Ministria Denaj garanoi se në Projektbuxhetin e vitit të ardhshëm respektohet kufiri që pagesat vjetore neto për kontratat koncesionare/PPP nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 për qind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor, pasi për vitin 2020 këto pagesa kapin një shifër prej 3.3% të këtij totali.

BUXHETI 2020 NË MBËSHTETJE TË INTEGRIMIT EUROPIAN



Projektbuxheti i vitit 2020 mbështet reformat në kuadër të integritimit në Bashkimin Europian. Ndërsa prezantoi draftin në komisionin e Integritimit Europian, Ministria Denaj vlerësoi se dy janë momentet më të rëndësishme sa i përket plotësimit të kriterit politik dhe atij ekonomik në kuadër të integritimit europian: Reforma në Drejtësi dhe Reforma në Administratën Publike, të cilat mbështeten financiarisht për vitin 2020. Buxheti i shtetit ka përballuar kostot vjetore lidhur me Reformën në Drejtësi që prej vitit 2016, kur u miratuan ndryshime kushtetuese, kosto që në vitin 2020 pritet të shkojë në 6 miliardë lekë.

SIGURIA KOMBËTARE DHE BUXHETI



Projektbuxheti 2020 mbështet me prioritet përbushje të objektivave madhorë të garantimit të sigurisë kombëtare, kryesisht për mbrojtjen dhe sigurinë e rendit publik; parandalimin dhe luftën ndaj kimit; si dhe përgjigjen në kohë dhe me efikasitet ndaj emergjencave civile për të garantuar të drejtat dhe liritë kushtetuese të çdo qytetari shqiptar. Projektbuxheti 2020 do të alokojë 3.2 miliardë lekë më shumë për Ministrinë e Mbrojtjes, në krahasim me buxhetin fillestar për vitin 2019, duke përbushur kështu angazhimin e Qeverisë për të rritur buxhetin e mbrojtjes në 2% të PBB në vitin 2024.

FUQIZIMI EKONOMIK I PAK PËRMES PUNËSIMIT



Falë politikave të ndërmarra dhe zbatimit të programave të dedikuara, në katër e vitet e fundit janë punësuar gjithsej 318 Persona me Aftësi të Kufizuara, ndërsa 177 persona janë punësuar nëpërmjet shërbimeve të ndërmjetësimit nga Zyrat e Punës. Në konferencën përmbyllëse të programit "Fuqizimi Ekonomik i Personave me Aftësi të Kufizuara përmes Punësimit", Ministria Denaj vlerësoi angazhimin e qeverisë për rritjen e aksesit në tregun e punës të PAK, përmes programeve të posaçme dhe të dedikuara, që kanë kontribuar në lehtësimin e integritimit të tyre në jetën shoqërore dhe ekonomike të vendit.

VËMENDJE NDAJ ARSIMIT PROFESIONAL



Ministria e Financave dhe Ekonomisë mbështet zhvillimin e arsimit profesional praktik dhe modern për të plotësuar nevojat e biznesit me fuqi punëtore të kualifikuar. Falë vëmendjes së shtuar të qeverisë ndaj arsimit profesional në vitet e fundit, duke synuar një përshtatshmëri më të madhe me nevojat e tregut të punës dhe biznesit, numri i nxënësve në shkollat e arsimit profesional është rritur me rreth 3.4%. Në aktivitetin e organizuar nga Dhoma Kombëtare e Zejtarisë, Ministria Denaj theksoi rëndësinë e kualifikimit të fuqisë punëtore në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe u shpreh se qeveria është e angazhuar për zhvillimin e një sistemi arsimor profesional të orientuar drejt kurrikulave bashkëkohore të bazuara mes ndërthurjes së teorisë me praktikën.

BASHKËPUNIMI EKONOMIK SHQIPËRI GJERMANI



Thellimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit ekonomik në fushat e turizmit, bujqësisë, agropërpunimit dhe arsimit profesional ishin në fokus të diskutimeve gjatë një takimi që Ministria Denaj pati me Sekretaren e Shtetit për Çështjet Ekonomike, Transportin, Bujqësinë, të Shtetit Rheinland Pflaz, të Republikës Federale të Gjermanisë, znj. Daniela Schmidt. Ministria Denaj dhe znj. Schmidt nënshkruan mes tyre një memorandum mirëkuptimi, të cilin e konsideruan si një bazë shumë të mirë për zgjerimin bashkëpunimit. Gjermania ka një model të arsimit profesional të suksesshëm, modelin dual, i cili ndërthuret mes teorisë dhe praktikës, dhe Shqipëria mund të përfitojë shumë nga përvoja gjermane.

LUFTA KUNDËR INFORMALITETIT



Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka ushtruar 484 kontrolle gjatë periudhës 16-21 nëntor, në zbatim të planit operacional kundër informalitetit. Nga këto kontrolle janë konstatuar 109 shkelje të legjislacionit tatimor. Sipas të dhënave të Administratës Tatimore rezultojnë: 10 subjekte të paregjistruara; 14 tatimpagues të penalizuar për shkeljen e moslëshimit të kuponit tatimor (rasti i parë); 13 tatimpagues me punonjës të padeklaruar; 4 tatimpagues janë konstatuar se nuk kanë pasur të instaluar pajisjet fiskale dhe 5 tjerë nuk i mbanin pajisjet fiskale në gjendje pune; 29 tatimpagues janë konstatuar se dispononin mallra pa dokumentacion tatimor.

PUNËSIMI PËRMES ZYRAVE TË PUNËS



504 persona janë punësuar përmes zyrave të Punës në gjithë vendin gjatë periudhës 8-14 nëntor 2019. Numrin më të madh të të punësuarve e ka qarku i Tiranës me 174 persona, ndjekur nga qarku i Durrësit me 57 persona, qarku i Elbasanit me 46 persona, qarku i Beratit me 44 persona, qarku i Fierit me 37 persona, etj.